


## **Vizitë studimore pranë SAI-t të Norvegjisë nga Departamenti i Auditimit të Performancës për auditimin me temë “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”**

Në kuadër të bashkëpunimit të KLSH-së me SAI-n e Norvegjisë në auditimin e performancës me temë “*Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit*”, nga data 22-26 prill 2023 u zhvillua një vizitë në Institucionin Suprem të Auditimit të Norvegjisë. Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Alfred Zylfi dhe grupi i auditimit: z. Aulent Guri, zj. Xhuljeta Çelaj, zj. Jorida Zhegu, zj. Olisa Foto.

Qëllimi kryesor i kësaj vizite ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave në auditimin e performancës me fokus aspektet mjedisore, mundësitë për zhvillimin e auditimit të performancës si dhe diskutimi nga afër i projekt-raportit të auditimit me ekspertët e SAI-t të Norvegjisë.

Gjatë kësaj vizite u analizuan në detaje projekt-raporti i auditimit të performancës me temë “*Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit*”, duke vënë theksin në vlerësimin dhe përpunimin e të dhënave të flotës së mjeteve rrugore, nivelin e cilësisë së ajrit si dhe harmonizimin e politikave dhe praktikave kombëtare me ato ndërkombëtare.

Gjithashtu, shkrimi dhe evidentimi i çështjeve me shumë rëndësi ishte kryefjala e kësaj përvoje. Audituesit e SAI-t të Norvegjisë sollën në vëmendje disa parime dhe standarde që ata ndjekin gjatë hartimit të raportit të auditimit. Krahas diskutimeve mbi projekt-raportin tonë të auditimit, SAI i Norvegjisë paraqiti disa prezantime lidhur me çështje metodologjike të auditimit të performancës, kontrollin e cilësisë etj.



Një rëndësi të veçantë pati prezantimi i kryer nga Instituti i Ekonomisë së Transportit të Norvegjisë, në të cilin u paraqitën risitë më të fundit në fushën e transportit rrugor dhe ndikimit të tij në cilësinë e ajrit dhe jo vetëm.

Në përfundim, pjesëmarrësit e KLSH-së u përshëndetën nga Sekretari i Përgjithshëm i SAI-t të Norvegjisë, z. Jens Gunvaldsen, i cili vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin e deritanishëm midis dy institucioneve homologe si dhe rëndësinë e takimeve të tilla me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira.

